DEKRET
Nr.7441, datë 1.12.1990

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJE E DEKRETE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës;
Me propozimin e Këshillit të Ministrave

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.4407, datë 25.6.1968 "Për pyjet", në nenin 17 shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

"Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative në pyje bëhet nga një komision me jo më pak se tre anëtarë i ngritur pranë ndërmarrjes pyjore, që caktohet nga drejtori i saj.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve nga shpallja e vendimit ose e njoftimit të tij, te drjtori i ndërmarrjes pyjore, akti i të cilit është i formës së prerë".

Neni 2

Në ligjn nr.4624, datë 24.12.1969 "Për sistemin e ri arsimor" në nenin 7, paragrafi i fundit ndryshohet si vijon:

"Prindërit e kujdestarët, kur nuk i dërgojnë fëmijët rregullisht në shkollë gjatë vitit mësimor dënohen për kundërvajtje administrative me qortim shoqëror ose me gjobë gjer në 50 lekë dhe, në rast përsëritjeje gjer në 300 lekë.

Shqyrtimi i kundërvajtjes bëhet nga një komision i ngritur pranë shkollës, që caktohet nga drejtori i saj.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve nga shpallja e vendimit ose e njoftimit të tij, te drejtori i shkollës, akti i të cilit është i formës së prerë".

Neni 3

Në ligjin nr.5840, dastë 20.2.1979 "Për regjistrimin e akteve të gjendjes civile", neni 30 ndryshohet si vijon:

"Shtetasit, të cilët sipas këtij ligji janë të detyruar të bëjnë deklarimin e lindjes ose të vdekjes, ose kërkesën për regjistrimin në vendbanimim e ri, në qoftë se pa shkaqe të arsyeshme nuk e bëpjnë këtë deklarim ose kërkesën brenda afatit të caktuar, dënhen për kundërvajtje administrative me qortim shoqëror, ose me gjobë gjer në 100 lekë nga nëpunësi i zyrës përkatëse të gjendjes civile.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve nga shpallja e vendimit ose e njoftimit të tij, te përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile të rrethit, akti i të cilit është i formës së prerë".

Neni 4

Në ligjin nr.5841, datë 20.2.1979 "Për shërbime postare dhe të telekomunikacioneve", neji 16 ndryshohet si vijon:

"Shkelja e dispozitave të parashikuara në nenet 3, 4 e 10 të këtij ligji, kur nuk përbën vepër penale, dënohet për kundërvajtje administrative me qortim shopqëror ose me gjobë gjer në 500 lekë nga një komision i ngritur pranë drejtorisë së PT-së në rreth, që caktohet nga drejtori i saj.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve nga shpallja e vendimit ose e njoftimit të tij, te drejtori i drejtorisë së PT-së në rreth, akti i të cilit është i formës së prerë".

Neni 5

Në dekretin nr.2450, datë 27.5.1957 “Për përgjegjësinë e prindërve për sjellje të këqija të fëmijëve dhe mbi masat për edukimin e tyre”, neni 1 ndryshohet si vijon:

“Prindërit për sjellje të këqija dhe për rrugaçëri (sjellje që prekin rendin shoqëror dhe rregullat e bashkëjetesës socialiste) të fëmijëve të tyre të mitur, që nuk e kanë mbushur moshën 14 vjeç, dënohen për kndërvajtje administrative me qortim shoqëror, ose me gjobë gjer në 500 lekë nga shefi i policisë së rrethit.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve nga shpallja e vendimit ose e njoftimit të tij, te krytari i degës së punëve të brendshme të rrethit, akti i të cilit është i formës së prerë.

Neni 6

Në dekretin nr.3161, datë 10.10.1960 “Për ndalimin e bashkëjetesës si bashkëshortë pa lidhur martesë” neni 1 ndryshohet si vijon:

“Burri që bashkëjeton me një grua si bashkëshort pa lidhur martesë të rregullt përpara organit të gjendjes civile, megjithëse nuk ka asnjë pengesë lgjore për lidhjen e martesës, dënohet për kundërvajtje administrative me qortim shoqëror ose me gjobë gjer në 1000 lekë nga punonjësi i zyrës së gjendjes civile përkatëse.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve nga shpallja e vendimit ose e njoftimit të tij, te përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile të rrethit, akti i të cilit është i formës së prerë“.

Neni 7

Në dekretin nr.4650, datë 9.3.1970 “Për kufirin shtetëror të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë“, neni 12 ndryshohet si vijon:

“Hyrja pa leje në zonat kufitare, në zona të tjera të ndaluara, si dhe çdo shkelje tjetër e dispozitave në lidhje me lëvizjen dhe qëndrimin e shtetasve në këto zona, kur vepra kryhet për herë të parë, fomon kundërvajtje administrative dhe dënohet me qortim shoqëror ose me gjobë nga 50 gjer në 1000 lekë nga komandanti i postës së kufirit.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga shpallja e vendimit ose e njoftimit të tij, te kryetari i degës së punëve të brendshme të rrethit, akti i të cilit është i formës së prerë“.

Neni 8

Në dekretin nr.5123, datë 4.12.1973 “Për detyrimin e specialistëve të rinj për të punuar në vendet ku caktohen”, në nenin 3 shtohen dy paragrafë me këto përmbajtje:

“Shqyrtimi i kundërvajtjers bëhet nga përgjegjësi i seksionit të kuadrit të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve nga shpallja e vendimit ose e njoftimit të tij, te drejtori i ndërmarrjes pyjore, akti i të cilit është i formës së prerë".

Neni 9

Në dekretin nr.5607, datë 30.6.1977 “Për ekonominë e gjuetisë”, në nenet 5 dhe 11 fjalët “Komiteti i Çmimeve dhe i Standardeve” zëvendësohen me fjalët “Komisioni i Planit të Shtetit”, kurse në nenin 11 shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

“Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative në gjueti bëhet nga një komision me jo më pak se tre anëtarë, i ngritur pranë ndërmarrjes pyjore, që caktohet nga drejtori i saj.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve nga shpallja e vendimit ose e njoftimit të tij, te drejtori i ndërmarrjes pyjore, akti i të cilit është i formës së prerë”

Neni 10

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI
SIHAT TOZAJ

KRYETARI
RAMIZ ALIA